

Shtojca 2: Deklarata nën betim nga tenderuesi dhe parandalimi i konfliktit të interesit

	Emri(at) dhe adresa(et) e subjekteve juridike ose subjekteve që paraqesin këtë propozim
Emri i ofertuesit/Anëtarët e konsorciumit	[Shëno emrin e ofertuesit]
Nr. i Regjistrimit/Nr. Unik	

Unë, i poshtëshënuari, parashtrojë ofertën për të siguruar shërbimet për Furnizimi dhe servisimi i gjeneratorit në përputhje me Ftesën për Propozime Nr. FPP 07/2022. Me anë të këtij dokumenti po dorëzojë ofertën tonë, e cila përfshin Propozimin Teknik dhe Propozimin Financiar dhe deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje kushtet e përcaktuara në këtë dosje të tenderit.

Ne kemi rishikuar me kujdes listën e të gjithë punonjësve të KCSF-së dhe anëtarëve të bordit dhe bazuar në informatat në dispozicion, ne vërtetojmë, me sa kemi njohuri dhe besim, se nga data e shënuar më poshtë, nuk kemi lidhje aktuale ose potenciale që mund të paraqesin konflikt interesi.

Ne deklarojmë që kompania jonë, bashkëpunëtorët, filialet ose punonjësit e saj, duke përfshirë çdo anëtarë të Konsorciumit/Shoqatës ose nënkontraktuesve ose furnizuesve për ndonjë pjesë të kontratës:

1. nuk kanë konflikt interesi në përputhje me Udhëzimet për ofertuesit;
2. nuk kanë deklaruar falimentim, nuk janë përfshirë në procedurat e falimentimit ose likuidimit dhe nuk ka asnjë vendim gjyqësor ose veprim ligjor në pritje kundër tyre që mund të dëmtojë operacionet e tyre në një të ardhme të parashikueshme;
3. marrin përsipër të mos përfshihen në praktika të ndaluara, duke përfshirë por pa u kufizuar në korrupsion, mashtrim, detyrim, marrëveshje të fshehtë, pengim ose ndonjë praktikë tjetër joetike, dhe të kryejnë punë në një mënyrë që shmang çdo rrezik financiar, operacional, të reputacionit ose rrezik tjetër të papërshtatshëm për KCSF-në.

Ne deklarojmë se të gjitha informacionet dhe deklaratat e bëra në këtë Ofertë janë të vërteta dhe ne pranojmë që çdo keqinterpretim ose shtrembërim i përfshirë në këtë Ofertë mund të çojë në skualifikimin tonë.

Ne ofrojmë të japim shërbime në përputhje me dokumentet në këtë dosje, përfshirë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës dhe në përputhje me Termat e Referencës.

Propozimi ynë do të jetë i vlefshëm dhe do të mbetet i detyrueshëm për ne për periudhën kohore të specifikuar në Ftesën për tender.

Ne e kuptojmë dhe e pranojmë që ju nuk jeni të detyruar të pranoni asnjë ofertë që merrni.

Unë, i nënshkruari, vërtetoj se jam i autorizuar ligjor nga [Shëno emrin e ofertuesit] për të nënshkruar këtë ofertë dhe për të lidhur kontratë nëse KCSF-ja e pranon këtë ofertë si të suksesshme.

Emri: _____

Titulli: _____

Data: _____

Nënshkrimi: _____